



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

SCC-09-0123

Parashtruesi i padisë:

B (R) F, nga Kaçaniku të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Daut Rudi, avokat nga Kaçaniku.

Kundër

Pala kundërshtare:

Ndërmarrja Shoqërore KB "MLADOST" Shtërpcë, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. "Agim Ramadani", Nr. 23, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, kolegji i përbërë nga Manushe Karaçi, gjyqtare kryesuese, Shkelzen Sylaj dhe Lindita Jakupi gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 14 dhjetor 2021, lëshon këtë:

AKTGJYKIM PËR MOSPARAQITJE

- I. Hedhet poshtë padia e paditësit.**
- II. Në këtë çështje juridike nuk caktohen taksa gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Më 8 korrik 2009, paditësi përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar ka parashtruar padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme me të cilën ka theksuar se i njëjti është pasardhës i tani të ndjerit, Sh E M, ish nga Kaçaniku, i cili ka qenë pronar i pasurive të paluajtshme në sipërfaqe të tërësishme prej: 0.91.00 ha, dhe atë: pjesë e ngastrës kadastrale nr. 64, në vendin e quajtur "Ç", me kulturë mal, klasa e I-rë, të evidentuara në Fletën poseduese, nr. 106, Komuna kadastrale - Soponicë, sipas Operatit kadastral i cili ka qenë në fuqi pas aeroinqizimit të vitit 1958, dhe si provë ka paraqitur Certifikatën e Drejtoratit për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë pranë KK Kaçanik, 08-nr. 383704.

Më tej paditësi ka sqaruar se me reformën agrare të vitit 1923, Mbretëria Serbe, pa kurrfarë baze ligjore e në baza diskriminuese i ka shpronësuar nga paluajtshmëritë e tyre duke iu ndarë paluajtshmëritë e cekura, kolonëve serbo-malazezë, mirëpo me çlirimin e vendit në vitin 1946, Këshilli i Rrethit iu ka kthyer pronarëve juridik këto paluajtshmëri e të cilat i kanë marrë prapë në posedim dhe shfrytëzim të pandërprerë paraardhësi i paditësit deri në vitin 1962. I njëjti deri në vitin 1965 ka paguar edhe kontributet e nevojshme shtetërore.

Në vitin 1962, Shërbimi pronësor juridik pranë KK Kaçanik, përmes Komisionit për shqyrtim të çështjeve pronësore juridike, ka ushtruar fletëparaqitje me pretendim se pasuria kontestuese është pronë shoqërore. Kësisoj, ky Komision me Aktvendimin nr.8634, të datës 04.06.1962, e ka kontestuar të drejtën e pronësisë me arsyetimin se pasuria lëndore është pronë shoqërore, ashtu që pronarin legjitim e ka shpallur uzurpues. Tutje në padi, parashtruesi i padisë përmes të autorizuarit të tij ka theksuar se në vitin 1963, Këshilli komunal i Kaçanikut në mënyrë arbitrare ka marrë Aktvendimin. 01 nr. 4333 me datën 23.09.1963, me të cilin paluajtshmërinë e pronarit legjitim i jep në shfrytëzim të përhershëm KB “ Ramadan Agushi”, dhe poashtu pas dy muajsh, me Aktvendimin, 01 nr. 5251 të dt. 11.11.1963, të njëjtës kooperativë i jep pëlqimin që paluajtshmërinë e dhënë në shfrytëzim, t’ia bartë Kombinativ Industrial “Kosmet Eksport”, nga Prishtina. Padiësi i ka propozuar gjykatës që të njëjtit t’i njihet e drejta e pronësisë, objekt i kësaj çështje juridike-civile.

Më 28 maj 2009, padiësi përmes përfaqësuesit të autorizuar e ka njoftuar AKP-në lidhur me ngritjen e padisë kundër K ‘M’ - Shtërpcë. Gjykata gjen në shkresa të lëndës se padiësi e ka dorëzuar Aktvendimin e plotfuqishëm T. nr. 69/05 të datës 19 dhjetor 2005, për shqyrtimin e trashëgimisë, me të cilin trashëgimtar në tërë masën e trashëgimisë së të ndjerit shpallet Sh E M.

Tutje si provë parashtruesi ka deponuar në gjykatë edhe certifikatën e Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronësi 08-nr.3837/04 të datës 6 dhjetor 2004, në bazë të së cilës vërtetohet se Sh E M, nuk ka në emër të tij paluajtshmëri të regjistruar. Në bazë të Aktvendimit, nr. 1029 të datës 25 prill 1962, Sh E M ishte shpallur uzurpues në pjesën e parcelës kadastrale, nr. 64, në sipërfaqe prej 0.91.00 ha, sipërfaqe kjo e evidentuar në numrin 64/8. Në vitin 1967 kjo parcelë ishte ndarë në dy pjesë 64/1 dhe 64/2, në vendin e quajtur ‘Ç’ me kulturë mal, klasa I-rë e evidentuar në Fletën poseduese, nr. 106 në emër të KBI Kosmet-Export në Prishtinë. Parcela kadastrale, nr. 64/8, nuk ekziston në planet kadastrale dhe në foto-skicat e aeroincizimit të vitit 1958. Më 15 maj 2009, Gjykata Komonale në Kaçanik, ka nxjerrë Aktvendimin e saj, C. nr. 79/04 sipas të cilit, padiësi është detyruar për dorëzimin e aktvendimit në katër kopje dhe të bashkëngjis dëshminë e pagesës së taksës.

Ndër tjerash, gjykata gjen në shkresa të lëndës se parashtruesi në mbështetje të padisë së vet gjithashtu ka prezantuar vendimin e Kuvendit Komunal të Kaçanikut nr. 35 /04 të datës 12 prill 2004, mbi abrogimin e aktvendimeve dhe marrjen nga shfrytëzimi i tokës bujqësore. Me këtë vendim ishte abroguar Aktvendimi i Kuvendit Komunal të Kaçanikut mbi dhënien në shfrytëzim të përhershëm të tokës bujqësore në pronësi shoqërore të Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, K B ‘R A’, 01. nr. 4333 të datës 23 shtator 1963 dhe Aktvendimi mbi dhënien e pëlqimit KB ‘R A’ mbi bartjen e së drejtës së shfrytëzimit të tokës bujqësore në pronësi shoqërore Kombinati Industrial ‘Kosmet Eksport’ nga Prishtina 01 Nr. 5251/1 të datës 11.11.1963 dhe e njëjta iu merret nga shfrytëzimi i poseduesve të tanishëm. Me këtë vendim ishte obliguar Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronësi që në bazë të dokumentacionit ekzistues të bëjë ndarjen e pasurisë së paluajtshme ish pronarëve. Padiësi gjithashtu ka dorëzuar vendimin e Kuvendit Komunal të Kaçanikut 01 nr. 173/02 të datës 5 qershor 2002 në bazë të së cilit pronat kontestuese iu janë bartur në pronësi Komunës së Kaçanikut.

Më 8 korrik 2009, Dhoma e Posaçme i ka dorëzuar padiësit vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore. Në bazë të dëftesë pagesës e cila gjendet në shkresa të lëndës gjykata vëren se padiësi e ka paguar taksën gjyqësore më 14 korrik 2009. Më 23 tetor 2009, Dhoma e Posaçme ka nxjerrë

aktvendim në bazë të së cilit ishte aprovuar kërkesa e paditësit për ndihmë në përkthim. Më 21 nëntor 2013, Dhoma e Posaçme ka nxjerrë një urdhër për AKP-në, që në afat prej një muaji nga data e pranimit të këtij urdhri, e njëjta të dorëzojë mbrojtjen e saj.

Më 13 dhjetor 2013, AKP-ja dorëzoi mbrojtjen e vet për të kundërshtuar padinë e parashtruar nga përfaqësuesi i paditësit. AKP-ja si përfaqësuese ligjore e të paditurës i ka kundërshtuar të gjitha pretendimet e paditësit B R F, nga Kaçaniku, të paraqitura në padi, duke i konsideruar të njëjtat, si të pabazuara në ligj, me propozim që padia e paditësit duhet të refuzohet. E autorizuar e të paditurës, AKP-ja pretendon se padia e paditësit nuk i përmban të gjitha elementet që parashihen me nenin 253 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK-së), nr.03/1-006 dhe me nenin 27 të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme, nr. 04/L-033, përkritazi me bazën juridike. Sipas përfaqësueses së të paditurës padia e paditësit nuk përmban faqen 2, dhe ky fakt padinë e paditësit e bën të mangët. Poashtu AKP-ja konsideron se e paditura të drejtën e pronësisë (shfrytëzimit) e ka fituar në përputhje me nenin 20, të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore, sipas të cilit ligj, njëra nga mënyrat e fitimit të pronësisë është edhe ajo me anë të vendimit të organit shtetëror, pasi që një e drejtë e tillë është e fituar si rezultat i Aktvendimit, 01.nr. 4333 të datës 23.09.1963, dhe Aktvendimit, 01 nr.5251 të datës 11.11.1963.

E autorizuar e të paditurës, AKP-ja në mbështetje të nenit 10, të Shtojcës së Ligjit, nr. 04/L-034, i propozoi Gjykatës që pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të tyre të merr Aktvendim mbi refuzimin e padisë së paditësit si të pabazuar. Më 23 dhjetor 2013, gjykata ka nxjerrë një urdhër për paditësin që në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij urdhri, të dorëzojë përgjigje për të kundërshtuar mbrojtjen e AKP-së.

Duke ju referuar fletëkthesës e cila gjendet në shkresa të lëndës, gjykata gjen se parashtruesi i ankesës, përmes përfaqësuesit të autorizuar, e ka pranuar mbrojtjen e AKP-së, por nuk ka parashtruar ndonjë përgjigje në mbështetje të pretendimeve të veta.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, me qëllim të dhënies së mundësisë për palët që të paraqesin argumentet e tyre, kishte caktuar seancë dëgjimore për datën 6 dhjetor 2021, në orën 10:00. Pjesëmarrjen në këtë seancë e kanë konfirmuar përfaqësuesi i paditësit si dhe përfaqësuesja e të paditurës AKP. Në bazë të fletëkthesës e cila gjendet në shkresa të lëndës gjykata vëren se përfaqësuesi i autorizuar i palës paditëse, avokati Daut Rudi nga Kaçaniku, e ka pranuar urdhrin e gjykatës për pjesëmarrje në seancë më 18 nëntor 2021, por i njëjti nuk është paraqitur në seancë dëgjimore të caktuar për datën 6 dhjetor 2021, si dhe nuk ka parashtruar ndonjë kërkesë në gjykatë për të shtyrë seancën për ndonjë datë tjetër si dhe mosardhjen e tij nuk e ka arsyetuar.

Arsyetimi Ligjor:

Padia e paditësit hedhet poshtë.

Duke u mbështetur në nenin 2.4 dhe nenin 77.1.1.1 të Ligjit Nr. 06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbatoi dispozitat procedurale të këtij ligji.

Përfaqësuesi i palës paditëse, në bazë të fletëkthesës e cila gjendet në shkresa të lëndës urdhrin e gjykatës për seancë dëgjimore e ka pranuar më 18 nëntor 2021, por i njëjti nuk është paraqitur si dhe nuk ka parashtruar ndonjë kërkesë në gjykatë për të shtyrë seancën për ndonjë datë tjetër si dhe mosardhjen e tij nuk e ka arsyetuar. Në seancën dëgjimore të mbajtur më datën e cekur më lartë, përfaqësuesi i palës së paditur, i AKP-së, i propozoi gjykatës që në bazë të Nenit 58 paragrafi 2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të nxjerr Aktgjykim për mosparaqitje. Kolegji gjykues në seancë dëgjimore mori aktvendim me të cilin e aprovoi kërkesën e përfaqësuesit të AKP-së që të merret vendim në mungesë të palës paditëse dhe kësisoj kolegji e mbylli seancën duke bërë të ditur se lidhur me Aktgjykimin e nxjerrë palët do të njoftohen me shkrim.

Duke qenë se palët janë ftuar sipas rregullit dhe se përfaqësuesi i autorizuar i palës paditëse, avokati Daut Rudi nuk u paraqit në seancën dëgjimore të mbajtur më 6 dhjetor 2021 në orën 10:00, gjykata vlerësoi se janë përmbushur të gjitha kushtet për nxjerrjen e Aktgjykimit për mosparaqitje. Në bazë të nenit 58, paragrafi 2 i Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, parashihet që: *'Nëse parashtrues i ftuar sipas rregullit nuk paraqitet në seancë dëgjimore apo nëse braktis procedurat, atëherë gjyqtari(ët) gjegjës mund, pas parashtrimit të kërkesës nga pala kundërshtare, të nxjerrë një Aktgjykim për mosparaqitje kundër Parashtruesit duke hedhur poshtë kërkesën dhe duke urdhëruar Parashtruesin që të paguajë të gjitha shpenzimet procedurale'.*

Shpenzimet Gjyqësore:

Ndaj parashtruesit të padisë nuk caktohet taksë gjyqësore ngase të njëjtën e ka paguar më 14 korrik 2008. Duke u bazuar në Nenin 62 paragrafi 5 i Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Këshillë Juridike:

Në bazë të nenit 59 të Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, pala mund të parashtrojë kërkesë për prishjen e Aktgjykimi për Mosparaqitje brenda afatit prej një muaji nga data e pranimit të aktgjykimit në fjalë.

Gjyqtarja Kryesuese, Manushe Karaçi

Gjyqtar, Shkelzen Sylaj

Gjyqtare, Lindita Jakupi
